



**FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

[ Data : 24.10.2016]

**Për: Bashkimin e perkohshem te shoqerive “Eral Construction Company” shpk (15,29%), dhe “Alba Konstruksion” shpk (84.71%).**

**Procedura e prokurimit: “Tender i Hapur” me objekt : “Sistemim asfaltim i rrugës Lekdush – Bënçë – Tepelenë, Lot 1”.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Sistemim asfaltim i rrugës Lekdush – Bënçë – Tepelenë, Lot 1”.**

Kohëzgjatja: Brënda 12 muaj nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: **455,811,059 (katërqind e pesëdhjetë e pesë milionë e tetëqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëdhjetë e nëntë)** lekë pa tvsh.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 24.08.2016.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA QE KA APLIKUAR NE SISTEMIN ELEKTRONIK TE PROKURIMIT	OFERTA PA TVSH
1	ERAL CONSTRUCTION COMPANY	248,275,650.00
2	2 T	287,528,724.00
3	N.T.P. Eurokos-Dega ne Shqiperi	315,058,154.25
4	SALILLARI	321,679,955.00
5	EUROTEOREMA PEQIN	328,101,627.00
6	COBIAL	342,097,560.00
7	Victoria Invest International	372,507,208.92
8	4 A-M	386,297,016.00
9	GJOKA KONSTRUKSION	401,069,172.00
10	CURRI	401,075,987.00
11	RIVIERA	408,642,912.30
12	G.P.G. COMPANY	408,713,225.00
13	ALKO-IMPEX General Construcion	439,450,935.00
14	ALB - STAR	453,234,947.00
15	POWER INDUSTRIES	NUK KA PARAQITUR OFERTE
16	SENKA/L	NUK KA PARAQITUR OFERTE

Jane skualifikuar shoqerite:

**1 “2T” shpk (51%), dhe “Agbes Konstruksion” shpk (49%) per arsye se:**

Shoqeria “2T” shpk nuk ploteson kerkesen “Operatori Ekonomik duhet te disponoje vlera te mjaftueshme monetare per te realizuar objektin e tenderit pa marre paradhenie. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese vertetim nga një ose më shumë banka për gjendjen financiare në vlerë jo më të vogël se 10 % te vleres se fondit limit, të lëshuar jo më pare se 10 (dhjete) ditë nga dita e hapjes së ofertave” pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per te vertetuar kete kusht.

Shoqeria “2T” shpk nuk ploteson kerkesen “Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument që vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitet 2014 – 2015 dhe 2016” pasi ka paraqitur vertetime vetem per Tiranen, nderkohe qe sipas QKR kryen aktivitet edhe ne Qukes – Librazhd, Kastrat – Shkoder, Lezhe, Vlore dhe Kelmend – Shkoder.

Shoqeria “Agbes Konstruksion” shpk nuk ploteson kerkesen e pergjithshme per kualifikim lidhur me plotesimin e detyrimeve fiskale pasi, referuar vertetimit nr. 9185/1 prot, date 13.06.2016, leshuar nga organet tatimore, rezulton se ka nje detyrim te pa shlyer prej 25.363.504 leke. Duke gene se kjo eshte nje e mete thelbesore, komisioni vendosi te mos procedoje me shqyrtimin e metejshem te dokumentacionit te paraqitur nga kjo shoqeri.

## **2 “Euroteorema Peqin” shpk per arsye se:**

Nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me pikat e nevojshme te licenses, pasi bazuar ne dokumentacionin e paraqitur rezulton se nuk disponon pikat e licenses N.P – 12. A (Punime të inxhinierisë së mjedisit) dhe N.S – 10. B (Shtresa dhe mbistruktura speciale). Duke gene se kjo eshte nje e mete thelbesore, komisioni vendosi te mos procedoje me shqyrtimin e metejshem te dokumentacionit te paraqitur nga kjo shoqeri.

## **3 “Cobial” shpk (38%), dhe “Alb Building” shpk (62%) per arsye se:**

Shoqeria “Alb Building” shpk nuk ka paraqitur deklaraten mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike sipas Shtojcës 5, deklaraten mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9, deklaraten mbi angazhimin e mjeteve dhe deklaraten mbi angazhimin e stafit. Keto deklarata jane paraqitur te firmosura vetem nga perfaqesuesi i shoqerise “Cobial” shpk dhe jo ai i shoqerise “Alb Building” shpk, nderkohe qe secila shoqeri duhet te kishte paraqitur vecmas deklaratat e kerkuara.

Shoqeria “Alb Building” shpk nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me stafin drejtues, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar per inxhinieret topograf, gjeolog dhe elektrik, ndonese ka marre persiper te kryeje 62% te punimeve.

Shoqeria “Cobial” shpk nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me stafin drejtues, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar per inxhinier ndërtimi me profilin transport, inxhinier hidroteknik, inxhinier mekanik dhe inxhinier mjedisi (specialisti i deklaruar eshte kimist teknolog), ndonese ka marre persiper te kryeje 38% te punimeve.

## **4 “4AM” shpk (37%), dhe “Albavia” shpk (63%) per arsye se:**

Shoqeria “Albavia” shpk nuk ploteson piken 2.3.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim: “Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument që vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitet 2014 – 2015 dhe 2016”. Nga dokumentacioni qe kjo shoqeri ka paraqitur ne tender lidhur me punet e ngjashme rezulton se ne vitin 2014 ka kryer punime ne objektin “Rikonstruksion i rruges nga Ura Vajguore ne Bistrovicë” pa paguar detyrimet vendore

ne kete njesi. Ne kete menyre, deklarata e paraqitur per te provuar plotesimin e pikes 2.3.5 per kualifikim rezulton e rreme.

Shoqeria “4AM” shpk nuk ploteson piken 2.3.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim: “Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument që vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet per vitet 2014 – 2015 dhe 2016”. Nga dokumentacioni qe kjo shoqeri ka paraqitur ne tender (Ekstrakti historik) rezulton se kjo shoqeri kryen aktivitet edhe ne Lezhe, Kruje dhe Kukes dhe per keto njesi vendore nuk ka paraqitur dokumentacion per likuidimin e detyrimeve vendore.

#### **5 “Gjoka Konstruksion” shpk per arsye se:**

Nuk ploteson Kerkesen e Pergjithshme per Kualifikim lidhur me plotesimin e detyrimeve fiskale, pasi nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se ka detyrime ne shumen 6.168.228 leke per tvsh dhe 25.311 leke per tatim fitimin. Duke qene se kjo eshte nje e mete thelbesore, komisioni vendosi te mos procedoje me shqyrtimin e metejsheem te dokumentacionit te paraqitur nga kjo shoqeri.

#### **6 “Curri” shpk (68.64%), dhe “Bami” shpk (31.36%) per arsye se:**

Shoqeria “Curri” shpk nuk ka paraqitur vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës 11 “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore”, deklarata mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike sipas Shtojcës 5, deklarata mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7, deklarata mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9, deklarate me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet per vitet 2014 – 2015 dhe 2016.09.02

Shoqeria “Curri” shpk nuk ploteson numrin e nevojshem te punonjesve pasi numri mesatar i te punesuarve per periudhen e kerkuar eshte 121 persona nga 123 qe duhet te jete sipas perqindjes se punes qe ka marre persiper.

Shoqeria “Curri” shpk nuk ka paraqitur deklarate se makinerite nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera, duke mos plotesuar kerkesen 2.4.9 per kualifikim.

**7 “Riviera” shpk, “Beqiri” shpk dhe “Bitupave” shpk per arsye se:** Nuk kane paraqitur marreveshjen e bashkepunimit.

#### **8 “Alko Impex General Costrucion” shpk per arsye se:**

Nuk ploteson piken 2.3.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim “ *Operatori Ekonomik duhet te disponoje vlera te mjaftueshme monetare per te realizuar objektin e tenderit pa marre paradhenie. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese vertetim nga një ose më shumë banka për gjendjen financiare në vlerë jo më të vogël se 10 % te vleres se fondit limit, të lëshuar jo më pare se 10 (dhjete) ditë nga dita e hapjes së ofertave” pasi disponon ne banke 7.500.000 leke nga 45.581106 leke qe duhet te disponoje per te plotesuar kerkesen per kualifikim.”*

**9 “Alb Star” shpk per arsye se:**

Nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti ka paraqitur nje vertetim ku thuhet se per nje prej kontratave ka lidhur marreveshje per pagesen me keste, duke mos e plotesuar kete kusht.

**10 “Power Industries” shpk pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion.****11 “Senka/L” shpk pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e perkohshem te shoqerive **“Eral Construction Company” shpk (15,29%)**, dhe **“Alba Konstruksion” shpk (84.71%)** se oferta e paraqitur, me vlerë **248,275,650** lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **04.10.2016**.

Per proceduren ne daten 07.10.2016 ka paraqitur ankese shoqeria “4-AM” shpk (se ciles ju kthye pergjigje ne daten 11.10.2016) dhe ne daten 10.10.2016 ka paraqitur ankese shoqeria “Gjoka Konstruksion” shpk (se ciles ju kthye pergjigje ne daten 12.10.2016).